



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.961/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVWS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NPT “Global Com” me seli në Prishtinë kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1152/17, të datës 15.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.11.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1152/17, të datës 15.02.2021, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, në pikën paragrafin I. të dispozitivit është vendosur: Aprovohet kërkesëpadia e paditësit NPT “Global Com” me seli në Prishtinë, si e bazuar. Në paragrafin II. anulohet aktvendimi nr.05.2.1/392, 467/2011 dhe nr. 05.2.1/761/2011 i datës 05.06.2017 i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Në paragrafin III. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës në

Prishtinë që paditësit NPT “Global Com” me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumën prej 9,185.58€ (nëntëmijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë euro e pesëdhjetë e tetë cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. 3972/08.04.2011 dhe nr. 4679/21.04.2011 të proceduar në Zyrën Doganore në Pejë. Në paragrafin IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës Dogana e Kosovës, me të cilën e ka kundërshtuar të njëjtin për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa, të prishet aktgjykimi A.nr.1152/17 i datës 15.02.2021, si të pa bazuar me ligj, të refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar me ligj dhe të lënë në fuqi vendimin e kontestuar ose t’ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin e kundërshtuar nr.05.2.1/392, 467/2011 dhe nr. 05.2.1/761/2011 i datës 05.06.2017, ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve DUD-ave R-3972/08.04.2011, R-4679/21.04.2011 si dhe R-8862/03.07.2011 të Zyrës Doganore Pejë.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke

vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se e paditura në ri procedurë ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve DUD-ave me nr. 3972/08.04.2011 dhe R-4679/21.04.2011 të Zyrës së Brendshme Doganore Pejë me arsyetimin se ZBD Pejë ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor sipas metodës së katërt dhe të gjashtë të vlerësimit, përkatësisht nenit 34.2 (c) dhe 35 të KDAK-së, duke iu referuar vlerës së të dhënave të tregut dhe të dhënave të disponueshme pasi që subjekti tatimor në bazë të dokumentacionit të deklaruar nuk ka arritur të dëshmojë se vlera e deklaruar paraqet vlerën reale të mallit lëndor në vështrim të nenit 33 të KDAK-së dhe se vlera e deklaruar e mallit të deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim importi në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin për eksport përkatësisht import në vendin tonë. Gjykata për të llogaritur detyrimet importuese doganore për DUD-at me nr. 3972/08.04.2011 dhe nr. 4679/21.04.2011 të proceduar në Zyrën Doganore Pejë si dhe për të nxjerr shumën e paguar më tepër nga paditësi për detyrimet importuese doganore për mallin lëndor, si rezultat i rivlerësimit të mallit nga e paditura, gjykata me propozimin e përfaqësueses së autorizuar të paditësit ka caktuar ekspertizë financiare në këtë konflikt administrativ. Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertes financiare Mihrije Morina në ekspertizën financiare të datës 09.12.2020 dhe nga plotësimi i saj me datë 08.02.2021 është konstatuar se paditësi me rastin e paraqitjes për zhdoganim të materialeve të ndryshme ka bashkangjitur të gjitha dokumentet përcjellëse konform nenit 33 të KDAK-së dhe nenit 123 të UA nr. 11/2009 që ka të bëjë me implementimin e KDAK-së nr. 03/L-109 dhe atë DUD-at e kontestuar, faturat, kontratat e shitblerjes dhe urdhërpagesën e obligimeve doganore, sipas ekspertes paditësit i është ndryshuar baza doganore në vlerë prej 33,281.09€ ndërsa diferenca e detyrimeve shtesë të paguara nga paditësi si rezultat i rivlerësimit të mallit është në vlerë prej 9,185.58€. Gjykata e shkallës së parë e mori në tërësi si të besueshme ekspertizën financiare meqë e njëjta është profesionale e argumentuar mirë në raport me detyrat e caktuara nga gjykata. Në lidhje me arsyetimin e të paditurës të dhënë në aktvendimin e kontestuar sipas të cilës e paditura pasi ka analizuar dokumentacionin përcjellës të mallit ka gjetur se subjekti në procedurë për DUD-at e kontestuar nuk ka bashkangjitur deklaratën eksportuese, gjykata vlerëson se ky arsyetim i të paditurës nuk ka mbështetje ligjore në legjislacionin doganor të aplikueshëm, sepse në dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave nuk parashihet që deklarata eksportuese është dokument i cili

duhet bashkangjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit të importuar dhe për tu aplikuar metoda e parë e vlerësimit sipas nenit 33 par. 1 të KDAK-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërin dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, edhe përmes ekspertizës financiare si dhe plotësimit të saj që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, këtë pretendim e Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së Dytë, e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret kjo gjykatë, as në ankesë, e as në shkresat e lëndës, nuk ka gjetur asnjë provë që është e bazuar në ligj mbi bazën e të cilave e paditura e ka ngarkuar paditësin me pagesë shtesë në emër të taksave doganore importuese.

Në raport me pretendimet e të paditurës se vlera e faturës krahasuar me transaksionin bankar referuar faturës 069/2011 nuk përputhën, dhe se pagesat janë realizuar me datë 20.07.2011, dhe se data e transferit bankar është 03.02.2014 d.m.th tre vite më vonë se data e lëshimit të faturës. Këtë pretendim Kolegji i Gjykatës Komerciale e refuzoj si të pa bazuar për faktin se vlera e faturës dhe

vlera e mallit të deklaruar nga paditësi për DUD-in R-4679 të datës 21.04.2011 është në shumë prej 23,517.84€, ndërsa transferet bankare për këtë faturë janë realizuar në dy pjesë, me transferin e datës 20.07.2011 në vlerë prej 10,000.00€ si dhe transferin bankar të datës 03.02.2014 në vlerë prej 13,517.84€ e që të dy këto transfere japin vlerën e deklaruar të mallit prej 23,517.84€ ndërsa sa i përket pretendimit të paditurës në ankesë së ka dallim kohor në mes të faturës dhe transferit bankar ky pretendim nuk qëndron pasi që çështja e vonesës në pagesë është çështje e cila ka të bëjë me vullnetin e lirë të lidhur mes eksportuesit dhe importuesit ku në këtë rast neni 33 paragrafi 3 i KDAK-së parasheh: “Çmimi vërtet i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhet bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësin, ose nga blerësi për një palë të tretë për të përmbush obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë” Andaj çmimi i transaksionit nuk nënkupton vetëm çmimin vërtet të paguar , por edhe çmimin e pagueshëm, pra nënkupton edhe çmimin që duhet të bërë blerësi për shitësin për mallin e importuar ose të blerë. Po ashtu pretendimi i të paditurës se mungon deklarata eksportuese nuk qëndron pasi dispozitat ligjore të Kodit Doganor dhe të Akcizave, nuk parashihet detyrimi që deklaratës doganore duhet ti bashkëngjitet ky dokument për të vendosur mallin në qarkullim të lirë. Andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur duke u bazuar në interpretimin e drejtë të dispozitave ligjore sa i përket dokumenteve që duhet ti bashkëngjiten deklaratës doganore gjatë zhdoganimit të mallit, dhe nga kjo rezulton se paditësi ka paraqitur transaksionin bankar duke përshkruar edhe numrin e faturës për pagesën e mallit lëndor i cili dëshmon çmimin e blerjes realisht të paguar.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe

përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesat, e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.961/22, me datë 13.11.2023

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**